



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 416/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Deçan, paraqitur kundër Flamur Tolaj dhe Shkumbin Tolaj, për shkak të sulmit fizik, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11. 2013, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Deçan

#### Arsyetim

PZAP-i, me datë 31.10.2013 ka pranuar një ankesë nga LVV-ja, dega në Deçan me të cilën pretendohet se me datën 30.10.2013 në ora 19:00 në objektet e shkolles fillore në fshatin Pobërgj komuna e Deçanit pas mbajtjes së tubimit publik është shkaktuar një incident me një përleshje fizike ku në dalje të objektit shkollor me të përfunduar tubimi është sulmuar fizikisht dhe duke i shkaktuar lëndime trupore simpatizuesit të LVV-së Vedat Lokaj nga kater persona dy nga të cilat janë identifikuar e që janë Flamur Tolaj dhe Shkumbin Tolaj. Parashtruesi i ankesës thekson Policia e Kosovës nuk ka qene e pranishme në fillim të tubimit ashtu siç ka qene e paralajmëruar të mbahej në ora 19:00 dhe se prezenca e saj aty ishte vetem 20 minuta para se të përfundoj tubimi në fjalë.

Lidhur me këtë PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës për rastin në fjalë dhe kërkoi që ta informoj PZAP-in.

Në përgjigjen e datës 04.11.2013 të ofruar në PZAP nga Policia e Kosovës theksohet se për rastin në fjalë Policia e Kosovës me datën 30.10.2013 ka iniciuar rastin me nr. 2013-DC-459 në të cilën theksohet se rasti në fjalë ka të bëjë me lëndim i lehtë trupor dhe se për këtë rast njëri nga të dyshuarit është arrestuar dhe se për incidentin në fjalë është njoftuar Prokurori kujdestar i Shtetit e ku pas intervistimit me urdhër të prokurorit i dyshuari është lëshuar në procedurë të rregullt gjyqësore. Në raportin e policisë më tutje theksohet se me datën 03.11.2013 rreth orës 13:00 nga ana e prokurorit kujdestar i caktuar për mbulimin e procesit zgjedhor në komunën e Deçanit nga prokurorja Valbona Haxhosaj është intervistuar viktimja Vedat Lokaj e i cili ka deklaruar para prokurores se rasti nuk ka të bëjë fare me LVV sepse i njëjti i përket një subjekti tjetër politik dhe se me këtë raportin i rreshterit Fekë Haklaj është vërtetuar se është i saktë.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**Ankesa është e pabazuar.**

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për tu vërtetuar pretendimet ankimore se i dëmtuari Vedat Lokaj është anëtarë apo simpatizantë i LVV-së dhe së personat përgjegjës i përkasin ndonjë subjekti të caktuar politi, kjo vërtetohet edhe përmes raportit të policisë me nr. 2013-DC-469 të datës 30.10.2013, në të cilën theksohet se gjatë dhënies së deklaratës para prokurorit i dëmtuari Vedat Lokaj deklaroi se nuk i përket subjektit politik LVV-së, por i përket një subjekti tjetër politik, ndërsa rreth asaj se të dëmtuarit i është shkaktuar lëndim trupor rasti në fjalë është hapur pranë prokurorisë kompetente dhe çështja është në procedure te rregullt gjyqësore, prandaj PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 416/2013 më datën 04.11.2013



**Kryesuesi i panelit  
Nehat Idrizi**

***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*